




Disa hapa të thjeshtë për të ndihmuar nxënësit të bëhen qytetarë digjitalë

Përdorimi i përvojës suaj si profesionist në
arsim për t'i udhëzuar fëmijët dhe të rinjtë
në rrugën e tyre drejt qytetarisë digjitale

Titulli i publikimit në origjinal:
Easy steps to help learners become digital citizens
@Council of Europe, 2023

*Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi
e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht
politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.*

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë),
me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për
sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk
përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të
paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket
natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit.
Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon:
“© Këshilli i Evropës, 2023”.
Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/
përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose pjesëve
të caktuara të tij, duhet t’i drejtohen Drejtorisë së
Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg
Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë
publikim duhet t’i drejtohen Departamentit të Arsimit,
Këshilli i Evropës Ndërtesa Agora 1, Quai Jacoutot
67075 Strasbourg Cedex Francë education@coe.int

Ky publikim është përkthyer dhe botuar në gjuhën
shqipe në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për
Qytetari Demokratike në Shqipëri”, i financuar nga
Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida)

Kopertina dhe faqosja:
Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe
Publikimeve (SPDP), Këshilli i Evropës

Foto: © Shutterstock

Ky botim nuk i është nënshtruar redaktimit gjuhësor
nga Njësia Redaksionale e SPDP-së për korrigjimin e
gabimeve tipografike dhe gramatikore.

Botimi në shqip
© Këshilli i Evropës, nëntor 2025
Përkthimi Shqip: Disa hapa të thjeshtë për të
ndihmuar nxënësit të bëhen qytetarë digjital
Shtypur nga Këshilli i Evropës

Autore:

Janice Richardson
Veronica Samara

Përmbajtja

ÇFARË DO TË THOTË JESH QYTETAR?	4
ÇFARË ËSHTË QYTETARI DIGJITAL?	4
MBËSHTETJA E BREZNISË DIGJITALE	4
NGA T'IA NISIN MËSIMDHËNËSIT?	5
LISTA E KONTROLLIT PËR PROFESIONISTËT NË ARSIM	6
TË JESH <i>ONLINE</i>	
Akresi dhe përfshirja	7
Të mësuarit dhe krijimtaria	8
Njohuri për medien dhe informimin	9
MIRËQËNIA <i>ONLINE</i>	
Etika dhe empatia	10
Shëndeti dhe mirëqenia	11
Prania dhe komunikimi <i>online</i>	12
TË DREJTAT <i>ONLINE</i>	
Pjesëmarrja aktive	13
Të drejtat dhe përgjegjësitë	14
Privatësia dhe siguria	15
Ndërgjegjësimi i konsumatorit	16

Çfarë do të thotë të jesh qytetar?

■ Ne të gjithë jemi qytetarë të vendit në të cilin jetojmë. Megjithatë, në shoqërinë e sotme të pasur digjiitalisht, shumica prej nesh banojnë në hapësira të mbivendosura “reale” dhe “virtuale”, ku kufijtë përcaktohen vetëm nga platformat që përdorim në çdo moment. Edhe kur jemi *offline* (jashtë linje), ne ndikohemi vazhdimisht nga teknologjia digjitale që na rrethon.

■ Të jesh qytetar do të thotë të kesh të drejta dhe përgjegjësi të caktuara, të përbashkëta për të gjithë, të kontribuosh aktivisht në shoqëri dhe të përpiqesh ta bësh botën një vend më të mirë e më miqësor për brezin e ardhshëm. E njëjta gjë vlen edhe për qytetarët digjitalë, të cilët duhet t’i kuptojnë, t’i respektojnë dhe t’i mbrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si *online*, ashtu edhe *offline*.

■ Është roli i profesionistëve të arsimit dhe i familjeve, t’i ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë kompetencat për ta bërë këtë.

Çfarë është qytetari digjital?

■ Qytetaria Digjitale është si një kornizë, dhe në disa aspekte një filtër, që udhëzon mënyrën se si njerëzit e përdorin teknologjinë digjitale dhe sillen *online*, dhe i ndërgjegjëson ata për ndikimin që mund të ketë në jetët e tyre tani dhe në të ardhmen. Qytetarët digjitalë janë persona që mësojnë gjatë gjithë jetës, të vetëdijshëm për nevojën e një kuptimi kritik ndaj ndryshimeve të shpejta që teknologjia digjitale po sjell në botë. Ata:

- ▶ janë të hapur ndaj kulturave të tjera dhe perspektivave të njerëzve të tjerë;
- ▶ janë të aftë ta përdorin teknologjinë digjitale me përgjegjshmëri dhe efektivitet, dhe dinë si të sillen *online*;
- ▶ bashkëpunojnë në mënyrë kuptimplotë si *online*, ashtu edhe *offline*, dhe kontribuojnë pozitivisht në shoqëri;
- ▶ kuptojnë, mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e tyre dhe të të tjerëve;

▶ menaxhojnë me kujdes informacionin e tyre privat dhe atë të njerëzve me të cilët ndërveprojnë.

■ Qytetarët digjitalë shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë që sjell teknologjia digjitale, janë të vetëdijshëm për ndikimin e saj në jetën e përditshme dhe dinë si të shmangin rreziqet e të kapërcejnë vështirësitë e saj.



Mbështetja e breznisë digjitale

■ Pjesëmarrja, bashkëpunimi dhe veprimtaritë mësimore dikur zhvilloheshin në shtëpi, në shkollë, në lagje ose në komunitetin vendor. Por, në ditët e sotme, fëmijët e të gjitha moshave, shumë nga këto veprimtari i kryejnë në mënyrë digjitale, përmes telefonave celularë, aplikacioneve, laptopëve, tabletëve, lodrave, dhe, madje, edhe përmes pajisjeve, që mund të mbahen në dorë, siç janë orët elektronike. Pajisje të tilla si: videollogjës, makinat dhe televizori në dhomën e ndenjes, po lidhen çdo herë e më shumë me internetin.

■ Edukimi për qytetari digjitalë i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë ta përdorin teknologjinë digjitale në mënyrë krijuese dhe me përgjegjshmëri për të komunikuar, eksploruar, punuar, mësuar, luajtur dhe për të marrë pjesë në shoqëri. Ky është një proces i vazhdueshëm që zhvillon vlerat dhe qëndrimet e nevojshme për të kapërcyer diskriminimin e stereotipet dhe për të kontribuar aktivisht në kthimin e botës digjitale në një hapësirë të hapur, gjithëpërfshirëse e krijuese, ku njerëzit respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit, si dhe vetë njëri-tjetrit.

■ Edukimi për qytetari digjitale u ofron të rinjve tregues që do t'i ndihmojnë ata të bëhen:

- ▶ më përzgjedhës për personat që takojnë dhe llojin e aktiviteteve që bëjnë *online*;
- ▶ më rezilientë ndaj dëmit që mund të vijë nga gjërat që shohin dhe dëgjojnë *online*, sepse i kanë të vendosura filtrat e tyre personalë – kompetencat e tyre të qytetarisë;
- ▶ më të përshtatshëm ndaj situatave të reja, sepse janë të hapur ndaj pikëpamjeve, kulturave dhe praktikave të tjera.

Nga t'ia nisin profesionistët e arsimit?

■ Fëmijët dhe të rinjtë marrin pjesë në shumë lloje veprimtarish digjitale. Për të qenë sa më gjithëpërfshirës, Këshilli i Evropës i ka nënndarë këto aktivitete në dhjetë fusha të ndryshme, ose sektore, të cilat përgjithësisht grupohen në tri kategori kryesore: “Të jesh *online*”, “Mirëqenia *online*” dhe “Të drejtat *online*”, siç ilustron me poshtë. Kjo ndarje ua bën më të lehtë profesionistëve të arsimit të identifikojnë nevojat

më specifike të nxënësve, si dhe kompetencat e nevojshme për t'u përgjigjur këtyre nevojave.

Të jesh *online*: 3 fushat në këtë grup lidhen me përdorimin efektiv, krijues dhe të thelluar të teknologjisë digjitale në kontekste nga më të ndryshmet. Fokusi është të të menduarit kritik dhe rëndësia e pjesëmarrjes kuptimplotë dhe e barabartë në hapësirat e hapura digjitale.

Mirëqenia *online*: 3 fushat në këtë grup nënvizojnë nevojën për të vepruar në mënyrë etike dhe me empati, si *online*, ashtu edhe *offline*, dhe inkurajojnë praktika digjitale të balancuara e ergonomike.

Të drejtat *online*: 4 fushat në këtë grup kanë si synim t'i bëjnë qytetarët digjitalë më të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, dhe për mënyrat për të kundërshtuar ndikimin e teknologjisë digjitale në privatësi, siguri dhe gjithashtu në konsumerizëm.

■ Profesionistët e arsimit mund të ndihmojnë në fuqizimin e nxënësve për t'u bërë qytetarë digjitalë. Në këtë udhëzues, ne shpjegojmë disa hapa të thjeshtë për t'u ndjekur, për t'i ndihmuar ata të zotërojnë aftësitë e nevojshme për të vepruar me përgjegjshmëri dhe respekt *online*.



Lista e kontrollit për profesionistët në arsim

Përpara se t'i shihni të gjitha fushat një e nga një, mund t'i hidhni një sy kësaj liste kontrolli, për të parë se ku mund të kenë më shumë nevojë nxënësit tuaj. Lista mund të përdoret edhe si mënyrë për të nisur një bisedë me fëmijët dhe të rinjtë, që t'i nxisni ata të flasin me ju për veprimtaritë e tyre digjitale.

TË JESH ONLINE

- ▶ Nxënësit tanë e përdorin teknologjinë digjitale me bashkëmoshatarët në klasë për të bërë projekte dhe për të eksploruar gjëra të reja (për shembull, muzetë *online* ose laboratorët e shkencave *online*). PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata dinë si t'i përdorin motorët e kërkimit në mënyrë efektive dhe t'i krahasojnë rezultatet që marrin. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata dinë të bëjnë dallimin mes informacionit të besueshëm dhe atij jo të besueshëm, dhe të kontrollojnë vlefshmërinë e burimeve të informacionit që përdorin. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata e përdorin teknologjinë digjitale në mënyrë krijuese, e kuptojnë konceptin e të drejtës së autorit dhe janë të aftë të ndajnë përbajtjen që krijojnë. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata janë dëgjues dhe vëzhgues të mirë, të aftë për të marrë pjesë në debate të hapura dhe respektojnë pikëpamjet e bashkëmoshatarëve. PO ☐ JO ☐

MIRËQENIA ONLINE

- ▶ Nxënësit tanë janë të vetëdijshëm për sasinë e kohës që kalojnë *online* dhe për nevojën për të bërë pushime të rregullta nga aktiviteti *online* (në klasë dhe gjatë). PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e ruajtjes së një ekuilibri të shëndetshëm mes aktiviteteve ballë për ballë, fizike dhe atyre *online*. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ne kemi ngritur një sistem në shkollën tonë në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë dikë të cilit t'i drejtohen, sa herë që shqetësohen nga diçka që hasin *online*. PO ☐ JO ☐

- ▶ Në klasë, ne diskutojmë për sjelljen *online*, si dhe për gjurmët digjitale dhe cilësimet e profilin. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ne diskutojmë hapur për fokusin e grupeve *online* ku bëjnë pjesë nxënësit, dhe për mënyrën se si të ndërveprohet në mënyrë pozitive dhe kuptimplotë. PO ☐ JO ☐

TË DREJTAT ONLINE

- ▶ Nxënësit tanë janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre *online*, dhe e dinë se çfarë do të thotë ta përdorësh teknologjinë me përgjegjshmëri dhe në mënyrë etike. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ata janë të vetëdijshëm për llojin e informacionit që duhet të mbahet privat për veten e tyre dhe për njerëzit me të cilët ndërveprojnë, si dhe për arsyen pse. PO ☐ JO ☐
- ▶ Ne bëjmë diskutime të hapura për anët negative dhe pengesat e botës digjitale, si dhe për mënyrat se si mund të ndihmojmë për t'i përmirësuar gjërat. PO ☐ JO ☐
- ▶ E gjithë teknologjia digjitale në institucionin tonë është e pajisur me programe sigurie (softuer sigurie) dhe e mbrojtur nga mure mbrojtëse (firewalls). PO ☐ JO ☐
- ▶ Nxënësit tanë dinë si të kontrollojnë prej nga vijnë produktet që konsumojnë dhe janë të vetëdijshëm për ndikimin që zakonet e tyre të konsumit mund të kenë në mjedis. PO ☐ JO ☐

TË JESH ONLINE

Aksesi dhe Përfshirja

Garantimi i aksesit dhe i mundësive të barabarta në internet për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë që të mësojnë vlerat, qëndrimet, aftësitë, njohuritë dhe të kuptuarin kritik që u nevojitet për të shprehur me respekt mendimet e tyre *online* dhe *offline*.

PËRFSHIHU!

- ▶ Përfshini qytetarinë digjitale në aktivitetet e përditshme të klasës. Mos prisni derisa nxënësit të pajisen me teknologji digjitale për të filluar zhvillimin e kompetencave të tyre të qytetarisë digjitale!
- ▶ Jepuni nxënësve shembuj se pse dhe si mund ta mbrojnë të drejtën e tyre dhe të të tjerëve për akses në teknologji, dhe pse askush nuk duhet të përjashtohet nga aktivitetet.
- ▶ Mësojuni nxënësve të mbrojnë veten dhe të tjerët nëse ndihen ndonjëherë të përjashtuar në shkollë, ose në çdo moment *online*.



A e dini se...

... në nivel shoqëror, promovimi i gjithëpërfshirjes ka të bëjë me riformësimin e kornizave sociale dhe arsimore, në mënyrë që qytetarët të inkurajohen të evoluojnë dhe t'u jepet hapësira për ta bërë këtë.

SI ?

- ▶ Promovoni një mjedis shkollor pozitiv, ku nxënësit gëzojnë mundësi të barabarta dhe ndihen pjesë e komunitetit të shkollës, pavarësisht nga gjinia, aftësia e kufizuar, raca apo kultura.
- ▶ Së bashku me nxënësit, kërkoni *online* ose në lajmet e përditshme për histori rreth gjithëpërfshirjes dhe rëndësisë së diversitetit. Çfarë mund të bëjë shoqëria për të siguruar që të gjithë të kenë mundësi të barabarta, si *online*, ashtu edhe *offline*?
- ▶ Inkurajoni nxënësit të flasin hapur nëse ndihen ndonjëherë në siklet ose të përjashtuar, *online* apo *offline*. Diskutoni konceptin e aftësisë së kufizuar dhe kërkoni të kërkojnë platforma *online* që u përgjigjen nevojave të veçanta.

4 elemente themelore për të mësuar kudo dhe kurdo

- ▶ Zhvilloni aftësitë për të mësuar në mënyrë të pavarur
- ▶ Veproni, mos u mjaftoni vetëm me mendime
- ▶ Ndërtoni vetëbesim duke kontribuar pozitivisht në komunitet
- ▶ Ndërveproni në mënyrë kuptimplotë me të tjerët

TË JESH ONLINE

Të mësuarit dhe kreativiteti

Të ndihmojmë nxënësit të mësojnë gjatë gjithë jetës dhe të bëhen të aftë të përdorin mjetet digjitale në mënyrë krijuese dhe kontekste të ndryshme.

PËRFSHIHU!

- ▶ Përdoreni teknologjinë në klasë në mënyra që të mësuarit të kthehet në një përvojë pozitive për të gjithë.
- ▶ Stimuloni kreativitetin: mësojuni nxënësve t'i përdorin mjetet digjitale në mënyrë krijuese për të publikuar materiale *online*.
- ▶ Diskutoni për pronësinë e veprave krijuese për t'i ndihmuar nxënësit t'i kuptojnë më mirë çështjet e të drejtës së autorit.



A e dini
se ...

... në një botë gjithnjë e më komplekse dhe të paparashikueshme që ndryshon me shpejtësi, kreativiteti ndihmon qytetarët të përshtaten me mjedise të reja, t'u përgjigjen nevojave të reja shoqërore dhe të gjejnë zgjidhje për sfidat e shumta që sjell teknologjia.

SI ?

- ▶ Përfshini aktivitete kodimi në programet mësimore për të përmirësuar kuptimin e nxënësve mbi mënyrën se si funksionon teknologjia digjitale.
- ▶ Vizitoni një muze, një panair vendas ose një ekspozitë me nxënësit, më pas kërkojuni të gjejnë informacion shtesë *online* dhe të përgatisin një prezantim rreth përvojës së tyre. Mësojini si ta publikojnë prezantimin në blogun e shkollës.
- ▶ Ftojini nxënësit të zgjedhin mediumin e tyre (për shembull, të shkruajnë një artikull lajmi, të krijojnë një vepër arti ose një video) për të paraqitur idetë e tyre për një temë që u intereson. Më pas le të shohë e gjithë klasa krijimin e tyre. Si do të ndiheshin nëse dikush tjetër do të merrte meritat për të? Diskutoni të drejtën e autorit dhe kërkojuni të kërkojnë për "Creative Commons".

Licencat **Creative Commons (CC)** u ofrojnë të gjithëve, duke filluar nga individët e deri te institucionet e mëdha, një mënyrë të standardizuar për t'i dhënë publikut leje për të përdorur veprën e tyre krijuese, sipas ligjit për të drejtën e autorit. Ekzistojnë 6 lloje licencash CC (ju lutemi vizitoni: <https://creativecommons.org/about/cclicenses/>).

TË JESH ONLINE

Njohuri mbi medien dhe informimin

Zhvillimi i aftësisë së nxënësve për të kuptuar dhe për të interpretuar në mënyrë kritike përmbajtjen e medias digjitale, si dhe për të përdorur teknologjinë digjitale në shprehjen e ideve të tyre.

PËRFSHIHU!

- ▶ Në klasë, përfshini aktivitete që i inkurajojnë nxënësit që në moshë të hershme të analizojnë dhe të vlerësojnë informacionin.
- ▶ Tregojuni nxënësve se sa lehtë mund të ngarkohet përmbajtja në internet, dhe pse është shumë e rëndësishme që i gjithë informacioni të kontrollohet dy herë përpara se të postohet *online*.
- ▶ Ndihmohuni nxënësit të gjejnë mënyrat më të mira për të përdorur motorët e kërkimit kur kryejnë kërkime, dhe të zhvillojnë aftësitë për të analizuar, krahasuar dhe vërtetuar rezultatet.
- ▶ Eksploroni dhe diskutoni me nxënësit rreth teknologjive të reja dhe ato në zhvillim, siç janë pajisjet teknologjike të veshshme dhe ChatGPT, dhe se si kjo teknologji po e ndryshon botën ku jetojmë.



**A e dini
se ...**

... është absolutisht thelbësore që arsimi fillor t'u mundësojë qytetarëve të ardhshëm të kuptojnë, të kritikojnë dhe të krijojnë informacion. Përmes arsimit, qytetarët digjitalë duhet të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike, për t'u angazhuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë në komunitetin e tyre.

SI ?

- ▶ Me nxënësit, zgjidhni një temë dhe kërkojuni atyre të gjejnë më shumë informacion rreth saj duke përdorur një motor kërkimi. A ndryshon informacioni nga një faqe interneti në tjetrën? Si mund ta kontrollojnë që informacioni është shkruar ose publikuar nga një burim i besueshëm? A është e mundur të bëhet dallimi mes informacionit dhe reklamave?
- ▶ Analizoni në klasë posterin e IFLA-s "[Si t'i dallojmë lajmet e rreme](#)" dhe diskutoni 8 pikat e ilustruara.
- ▶ Kërkojuni nxënësve t'i tregojnë njëri-tjetrit mënyra se si i përmirësojnë kërkimet në internet për rezultate më të sakta. A janë ata të vetëdijshëm që duke vendosur një fjalë ose frazë në thonjëza "", marrin rezultate më të sakta me kërkesën? Si mund të përmirësohen rezultatet e kërkimit?
- ▶ Kërkojuni nxënësve të mendojnë rreth aftësive të nevojshme për të postuar përmbajtje në internet. Meqenëse kushdo, dhe jo vetëm ekspertët, mund të postojë informacion në internet, si mund ta kuptojmë nëse informacioni *online* është i saktë apo i vërtetë? A ka ndonjë mënyrë për të kuptuar nëse një përmbajtje është gjeneruar nga njerëzit apo nga makineritë (për shembull, ChatGPT)?

Lajme të rreme (Fake news): histori që ndoshta janë të rreme, që tërheqin shumë njerëz dhe që shpesh lexohen ose shikohen nga miliona njerëz. Lajmet dhe informacionet e rreme janë bërë shumë më të lehta për t'u krijuar dhe më të vështira për t'u dalluar për shkak të aplikacioneve të Inteligjencës Artificiale (IA), siç janë "deep fakes".

MIRËQENIA ONLINE

Etika dhe empatia

Krijojini mundësi fëmijëve dhe rinjve, që të mësojnë për gjëra të tilla, si: barazia, drejtësia dhe pranimi i diversitetit, e shumë më tepër, dhe inkurajojini të respektojnë ndjenjat dhe perspektivat e të tjerëve.

PËRFSHIHU!

- ▶ Flisni për etikën në klasë. Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë kuptimin e empatisë dhe rëndësinë e të qenit të vëmendshëm ndaj nevojave dhe pikëpamjeve të të tjerëve.
- ▶ Ndhimojini nxënësit të jenë më pranues ndaj vetes dhe të tjerëve, duke u theksuar se të gjithë ne jemi unikë, dhe i ndiejmë e i mendojmë gjërat ndryshe.
- ▶ Theksoni rëndësinë e pikëpamjeve të shumta dhe faktin se pikëpamjet e ndryshme mund të bashkëjetojnë pa problem krah për krah.
- ▶ Diskutoni në klasë për bullizmin dhe gjuhën e urrejtjes, dhe kërkoni nxënësve të sugjerojnë mënyra se si mund të zhvillohet empatia.



A e dini
se ...

... ndërveprimi pozitiv *online* mbështetet në një masë të madhe nga empatia.

SI ?

- ▶ Në grupe, kërkoni nxënësve të krijojnë një poster ku të listojnë parimet etike që ata mendojnë se duhet t'i ndjekim të gjithë, si *offline* ashtu edhe *online*.
- ▶ Organizoni lojëra me role për të inkurajuar nxënësit të reflektojnë mbi ndjenjat e tyre, si dhe të vëzhgojnë e të mendojnë për ndjenjat e të tjerëve.
- ▶ Organizoni diskutime në klasë për të theksuar se si pikëpamjet mes nxënësve shpesh ndryshojnë; kjo do t'i ndihmojë ata të mësojnë ta vlerësojnë diversitetin.
- ▶ Zhvilloni një diskutim në klasë rreth një historie të kohëve të fundit që mund të jetë publikuar *online* ose në media në lidhje me bullizmin ose gjuhën e urrejtjes. Si do të ndiheshin nxënësit nëse do të ishin në vendin e viktimës?

Empatia është aftësia për të kuptuar dhe për të ndarë ndjenjat e të tjerëve.

MIRËQENIA ONLINE

Shëndeti dhe mirëqenia

Krijimi i qëndrimeve, aftësive, vlerave dhe njohurive që ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të vetëdijësohen ndaj mënyrave se si teknologjia digjitale mund të ndikojë pozitivisht ose negativisht në trupin dhe mendjen e tyre.

PËRFSHIHU!

- ▶ Diskutoni me nxënësit për sasinë e kohës që ata kalojnë *online* dhe se si kjo mund të ndikojë në shëndetin dhe mirëqenien e tyre.
- ▶ Ndërveprimet pozitive në klasë ndihmojnë shumë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së nxënësve, e cila është e lidhur ngushtë me nivelin e tyre të besimit dhe vetëvlerësimit.
- ▶ Siguria, shëndeti (p.sh. postura, ergonomia) dhe mirëqenia e të rinjve duhet të jenë prioriteti kryesor i mësimdhënësve kur ata bëjnë zgjedhje për pajisjet digjitale dhe përmbytjen që do të përdoret në klasë.



A e dini
se ...

... integrimi i jetës *online* në jetën reale do të thotë se interneti nuk është i izoluar nga shoqëria e gjerë, por është pjesë e saj. Kjo do të thotë se jeta *online* mund të riprodhojë dinamika ose sjellje të dëmshme diskriminuese që ekzistojnë në shoqërinë e gjerë: ajo çfarë ndodh *offline*, sillet *online*, dhe anasjelltas.

SI ?

- ▶ Kërkojuni nxënësve të mbajnë një ditar për një javë, ku të shënojnë gjërat që bëjnë dhe kohën që kalojnë *online* e *offline*. Diskutoni ditarët e tyre në klasë për t'ua tërhequr vëmendjen ndaj praktikave dhe mënyrave të shëndetshme e më pak të shëndetshme të kalimit të kohës.
- ▶ Inkurajoni nxënësit të ndërtojnë dhe të jenë krenarë për aftësitë dhe shkathtësitë e tyre personale, në vend që të lejojnë veten të ndikohen së tepërmi nga opinioni i të tjerëve.
- ▶ Në grupe, kërkojuni nxënësve të hulumtojnë praktikat e shëndetshme *online* dhe ergonominë, dhe të krijojnë një poster rreth temës.

Për shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, është e rëndësishme që ata të mësojnë ta balancojnë kohën që kalojnë *online* me aktivitetet fizike dhe ato në natyrë.

MIRËQENIA ONLINE

Prania dhe komunikimet online

Zhvillimi i cilësive vetjake dhe ndërvetjake të nevojshme për të ruajtur një imazh të mirë *online* për veten dhe bashkëveprimet interesante dhe të vlefshme *online*.

PËRFSHIHU!

- ▶ Ndhimojini nxënësit të përmirësojnë cilësinë e pranisë së tyre digjitale, duke diskutuar në klasë për mënyra më të përgjegjshme të përdorimit të platformave të tyre të preferuara *online*.
- ▶ Nënvizoni rëndësinë e të qenit i sjellshëm dhe i respektueshëm në të gjitha komunikimet *online* dhe *offline*, si dhe përparësitë që kjo sjell.
- ▶ Shpjegoni se çfarë janë gjurmët digjitale dhe ndikimin që një gjurmë negative mund të ketë në mundësitë e ardhshme të karrierës.
- ▶ Theksoni disa nga dallimet thelbësore mes komunikimit *online* dhe atij *offline*. Për shembull, diskutoni mënyrën se si gjuha më pak e dukshme e trupit dhe shprehjet e fytyrës në komunikimin *online* mund të bëjnë që fjalët dhe veprimet të keqinterpretohen më lehtë ose të kenë një ndikim më të madh.



A e dini se ...

... qytetarët digjitalë duhet të jenë të aftë të krijojnë dhe të mirëmbajnë një prani të shëndetshme *online* dhe të komunikojnë me përgjegjshmëri, pa ndikuar negativisht në të drejtat e të tjerëve.

SI ?

- ▶ Kërkojuni nxënësve të printojnë një nga profilet e tyre *online* dhe ta vendosin në murin e klasës që ta shohin të gjithë. A do të ishin të lumtur ta bënin këtë? Pse duhet t'i shqetësojë kjo gjë, përderisa profili është i postuar *online* që ta shohë e gjithë bota?
- ▶ Në klasë, krijoni një udhëzues për mirësjelljen në internet me 10 rregullat kryesore që duhet të respektohen *online*. Më pas, kërkojuni nxënësve të mbajnë një regjistër për 2 javë, për të parë se cilat rregulla janë më të vështira për t'u ndjekur.
- ▶ Kërkojuni nxënësve të bëjnë një kërkim *online* për emrin e tyre. A pati ndonjë të papritur? A do t'ua tregonin prindërve gjithçka që gjetën për veten? A përputhet gjurma e tyre digjitale me atë që ata prisnin?
- ▶ Kërkojuni nxënësve të punojnë në grupe të vogla dhe të trillojnë diçka qesharake për një mik imagjinar, diçka që nuk do ta kishin problem ta postonin *online*. Më pas, kërkojuni grupeve ta lexojnë historinë e tyre me zë të lartë në klasë. A do të përdornin të njëjtën gjuhë dhe a do të thonin të njëjtën gjë për dikë në një situatë ballë për ballë?

Gjurma digjitale është gjurma e të dhënave që lëmë pas kur përdorim internetin. Ajo përfshin faqet e internetit që vizitojmë, mesazhet që dërgojmë, informacionin që postojmë...

TË DREJTAT ONLINE

Pjesëmarrja aktive

Roli aktiv në komunitetet *online* dhe *offline*, si dhe aftësia për të marrë vendime të përgjegjshme që ndihmojnë në përmirësimin e mjedisit digjital.

PËRFSHIHU!

- Organizoni aktivitete që u mundësojnë të rinjve të kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes aktive dhe argëtimin që ajo mund të sjellë.
- Organizoni debate në klasë mbi demokracinë dhe lirinë e shprehjes, dhe theksoni pse është kaq e rëndësishme që çdokush të jetë në gjendje të shprehë opinionin dhe pikëpamjet e tij.
- Me nxënësit, hulumtoni dhe diskutoni mënyrat se si kontekste të caktuara kulturore dhe/ose politike mund të ndërhyjnë në të drejtat e qytetarëve për të marrë pjesë aktivisht dhe lirisht në komunitetet *online* dhe *offline*.



A e dini
se ...

... vlerat dhe qëndrimet që ne mbajmë *online* formësojnë vazhdimisht mjedisin digjital, ashtu si veprimet e qytetarëve *offline* formësojnë komunitetin në të cilin jetojmë.

SI ?

- Mbështetuni në përvojën e nxënësve nga 'bota reale' gjatë aktiviteteve në grup si kampet verore, punëtoritë apo aktivitetet sportive, për të theksuar vlerën dhe kënaqësinë e pjesëmarrjes aktive.
- Zhvilloni një debat në klasë mbi një temë argëtuese, siç është zgjedhja e një ngjyre të re për fasadën e shkollës. Kërkojuni nxënësve të japin sugjerime dhe t'u 'shesin' idenë e tyre bashkëmoshatarëve. Mbylleni seancën me një votim për t'u treguar nxënësve fuqinë e ndikimit dhe rëndësinë e aktit demokratik të votimit.
- Flisni për një vend në botë ku pjesëmarrja aktive është e kufizuar dhe diskutoni se çfarë do të thotë kjo për qytetarët e tij dhe për demokracinë.

Pjesëmarrje do të thotë që njerëzit të përfshihen në vendimet që ndikojnë në jetët e tyre. Përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund të identifikojnë mundësitë dhe strategjitë për veprim, dhe të ndërtojnë solidaritet për të sjellë ndryshim.

TË DREJTAT ONLINE

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Njohja dhe të kuptuarit e të drejtave dhe përgjegjësiave tona si qytetarë në botën fizike dhe zbatimi i tyre në botën *online*.

PËRFSHIHU!

- ▶ Edukoni nxënësit që të mbrojnë të drejtat e tyre, të respektojnë përgjegjësitë e tyre dhe të respektojnë të drejtat e të tjerëve.
- ▶ Diskutoni të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve të platformave *online*, si dhe rëndësinë e sigurimit që ato të respektohen.
- ▶ Diskutoni me nxënësit saktësisht se çfarë informacioni mund të japin kur regjistrohen dhe përdorin platformat *online*.



A e dini
se ...

... mësimi për respektimin e të drejtave dhe përgjegjësiave digjitale është një nga hapat e parë t'u bërë një qytetar digjital aktiv.

SI ?

- ▶ Kërkojuni nxënësve që të bëjnë një listë të të drejtave dhe përgjegjësiave që ndiejnë se kanë në shkollë, dhe diskutoni me ta mënyrat se si këto mund të jenë të ndryshme në botën *online*.
- ▶ Shihni disa nga platformat më të njohura *online* që përdorin nxënësit, dhe kontrolloni Kushtet dhe Termat e disa prej tyre në klasë. A i mbrojnë të gjitha platformat të drejtat e përdoruesve, si respektimi i privatësisë, filtrimi i përmbajtjeve të dëmshme, dhe bllokimi i kërkesave për kontakt nga të panjohurit?
- ▶ Shumë platforma kryesore të medieve sociale deklarojnë: *"...[kur postoni përmbajtje] na jepni një licencë jo-ekskluzive, të transferueshme, me nënlicencim të mundshëm, pa pagesë royalties dhe globale për të hostuar, përdorur, shpërndarë, modifikuar, ekzekutuar, kopjuar, performuar ose shfaqur publikisht, përkthyer dhe krijuar vepra të përtuara nga përmbajtja juaj."* Çfarë do të thotë me të vërtetë kjo, dhe a është e pranueshme? Cilat nga të drejtat tona rrezikohen nga këto kushte?

Të drejtat janë rregulla themelore që përcaktojnë se çfarë u lejohet njerëzve ose çfarë u takon atyre brenda një sistemi ligjor ose shoqëror, për shembull, e drejta për lirinë e shprehjes. **Përgjegjësitë** janë detyra ose obligime që njerëzit janë të detyruar ose pritët të kryejnë, për shembull, të mbrojnë të tjerët.

TË DREJTAT ONLINE

Privatësia dhe siguria

Të mësojmë se si të mbrojmë informacionin dhe të dhënat personale të njerëzve me të cilët bashkëveprojmë, dhe të kuptojmë ndikimin që veprimet dhe sjellja jonë në internet mund të kenë tek të tjerët.

PËRFSHIHU!

- ▶ Sigurohuni që shkolla juaj të instalojë dhe të përditësojë rregullisht filtrat, muret mbrojtëse (firewalls) dhe programet antivirus, si dhe të kujdeset në mënyrë të veçantë për të dhënat private të nxënësve. Organizoni aktivitete argëtuese në shkollë që i mësojnë nxënësit se si të krijojnë fjalëkalime të forta.
- ▶ Në klasë, organizoni aktivitete që ndihmojnë nxënësit të dallojnë informacionin privat, të cilin nuk duhet ta ndajnë me të tjerët, nga ai që mund të ndahet lirshëm. A e kuptojnë ata se sa shumë informacion mund të japin pa dashje në internet?
- ▶ Flisni për skedarët e vegjël (cookies) dhe rëndësine e menaxhimit të duhur për të mbrojtur të dhënat tona.
- ▶ Diskutoni mënyrat se si mund të mbrohemi nga mesazhet e padëshiruara (spam), mashtrimet elektronike (phishing), dhe programet e dëmshme. Kujtojeni nxënësve që të mos u përgjigjen kurrë email-eve të dyshimta dhe të skanojnë çdo skedar që marrin papritur, para se ta hapin – edhe nëse duket se janë dërguar nga persona që i njohin. Gjithashtu, ata duhet të jenë të kujdesshëm kur klikojnë linqe të panjohura.



... cookies janë pjesëza të vogla të dhënash, të ruajtura në kompjuterët tanë nga faqet e internetit që vizitojmë. Ato regjistrojnë aktivitetin tonë *online* dhe historikun tonë të shfletimit.

SI ?

- ▶ Një mënyrë praktike për të krijuar fjalëkalime të forta është të formoni një fjali që mbahet mend lehtë, e cila përmban të paktën tetë fjalë, dhe të përdorni shkronjën e parë të çdo fjale si fjalëkalim. Për shembull, fjalia “Më pëlqen të ha picë me sallam dhe djathë” bëhet “mptpmdsd”. Më pas, ktheni disa shkronja kapitale, përdorni simbole (&, @, !) dhe/ose zëvendësoni një ose dy fjalë me një numër.
- ▶ Analizoni me nxënësit politikën e privatësisë së një platforme të njohur të mediave sociale. Çfarë të dhënash dhe përmbajtjesh mbledh platforma dhe si përdoren e shpërndahen ato? Tregojuni se si mund të rregullohen cilësimet e privatësisë, në mënyrë që ajo çfarë postohet *online* të mos jetë e dukshme publikisht dhe t’u shfaqet vetëm grupeve të zgjedhura.
- ▶ Vizitoni një faqe interneti me nxënësit dhe diskutoni se cilat lloje *cookies* janë vërtet të nevojshme dhe cilat mund të refuzohen. Përdorni një shfletues të njohur për të treguar se si mund të fshihen *cookies* dhe historiku.
- ▶ Shkarkoni disa email-e të njohura mashtruese dhe kërkojeni nxënësve të dallojnë mënyrat se si mund t’i identifikojnë dhe t’i shmangin mashtrimet dhe falsifikimet. Tregojuni atyre se si programet antivirus mund t’i mbrojnë të dhënat e tyre.

Shfletuesi privat ose *incognito* ju lejon të shfletoni internetin në mënyrë private. Kur të dilni nga shfletuesi, gjithçka që keni bërë në të do të fshihet, duke përfshirë historikun, *cookies* dhe sesionet.

TË DREJTAT ONLINE

Ndërgjegjësimi i konsumatorit

Kërkimi i sigurt brenda hapësirave sociale *online* si përdorues, konsumator dhe si sipërmarrës.

PËRFSHIHU!

- ▶ Diskutoni në klasë për të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorëve, duke theksuar se ato mbeten të njëjta pavarësisht nëse jemi *offline* apo *online*.
- ▶ Në klasë, përfshini aktivitete që nxisin sipërmarrjen dhe i inkurajojnë nxënësit të punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta, p.sh. krijimi i një faqeje interneti model për shitje *online*. Çfarë termash dhe kushtesh do të përfshinin ata?
- ▶ Flisni për reklamën dhe për mënyrat se si mund të ndikohemi nga reklamimi.
- ▶ Diskutoni në klasë rreth konsumit të qëndrueshëm dhe se si konsumatorët mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre e t'i respektojnë përgjegjësitë e tyre, si *offline* ashtu edhe *online*.



A e dini
se ...

... përmes edukimit të konsumatorit, edhe fëmijët e vegjël mund të kuptojnë shpejt se të gjithë kanë rolin e tyre, për ta bërë botën një vend më të mirë dhe më të drejtë.

SI ?

- ▶ Punoni me nxënësit për të krijuar një listë me të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorit, për shembull, kur blejnë pajisje elektronike, lodra ose veshje në një dyqan. Më pas, analizoni listën së bashku me ta për të diskutuar se si këto të drejta dhe përgjegjësi zbatohen *online*.
- ▶ Shqyrtoni disa faqe interneti tregtare dhe krahasojini ato me listën e kontrollit të kërkesave minimale në fund të kësaj faqeje. A mendojnë nxënësit se termet dhe kushtet janë të lehta për t'u kuptuar? A janë ato të mjaftueshme? A mungon diçka?
- ▶ Në grupe të vogla, kërkojuni nxënësve të zgjedhin disa reklama me të cilat dëshirojnë të punojnë (p.sh. për pajisje elektronike, lodra, ushqime, ëmbëlsira, etj.). Detyra e tyre është të analizojnë teknikat dhe strategjitë e përdorura për të na bërë të dëshirojmë t'i blejmë këto produkte.
- ▶ Ftojini nxënësit të bëjnë një listë me gjërat që do të donin të kishin, më pas kërkojuni të bëjnë një kërkim *online* për të zbuluar se ku gjendet burimi dhe ku prodhohen artikujt. A përfiton ekonomia kombëtare apo lokale e vendit të origjinës nga prodhimi, dhe a respektohen normat e tregtisë së drejtë?

Listë kontrolli e kërkesave për faqet e internetit të tregtisë elektronike

- ☒ Kompania që prodhon dhe shet produktin është e identifikuar qartë;
- ☒ Karakteristikat e produktit, termet e shërbimit dhe garancia janë lehtësisht të aksesueshme;
- ☒ Politika e privatësisë tregon se si të dhënat e konsumatorit ruhen, fshihen dhe bëhen të aksesueshme për konsumatorin;
- ☒ Çelësi dhe <https://> janë të dukshme në faqen e pagesës për të treguar se transaksionet janë të sigurta.

Shënime

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are no margins, text, or other markings on the paper.

Botime të tjera të Këshillit të Evropës për Edukimin e Qytetarisë Digjitale (<https://book.coe.int/eur/en>)

- ▶ Fletëpalosje për Mbrojtjen e të Dhënave: Mbrojtja e Privatësisë dhe e të Dhënave Personale (2022)
- ▶ Manuali për Edukimin e Qytetarisë Digjitale (botim 2022)
- ▶ Edukimi për një Kulturë të Videolojërave: Një hartë për mësuesit dhe prindërit (2021)
- ▶ Akt për eliminimin e përjashtimit dhe ngacmimit *online* dhe *offline* (2021)
- ▶ Manuali për Njohjen e Internetit (2017)

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në:

<https://www.coe.int/dce>

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.